



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**  
**MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA**  
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit Nr-03/L-040, per Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, paragrafi 2 shkronja (c), te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, rekomandimit 01-Nr-016-15779 të datës 06.04.2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 26.04.2018, miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Me këtë vendim ndalohet ushtrimi i veprimtarive të lokaleve afariste që ushtrojnë veprimtarin; kafiterit, ëmbëltore, diskotekat, klubet e natës, lojërat e fatit, bastoret sportive, dhe lokaleve tjera që shërbejnë pije alkoolike në Qendrën zeytare Nr-2, në Rr. "Luigj Gurakuqi", në Rr. "Dëshmorëve" dhe në Rr. "Hasan Prishtina", konkretisht në brendësin e trekëndëshit të Qendrën zeytare Nr-2.

**Neni 2**

Qendra zeytare Nr-2 në Suharekë gjendet në afërsi të dy shkollave kryesore të qytetit të Suharekës, shkollës fillore të mesme të ulët "7 Marsi", shkollës së mesme gjimnazi "Jeta e Re" dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF-së) në Suharekë.

Lokalet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e cekur në nenin 1, të këtij vendimi, vazhdimisht bëjnë prishjen e rendit dhe qetësisë publike, për shkak të zhurmës që shkaktojnë është e pamundur të zhvillohet procesi mësimi në kushte normale. Për kundër masave preventive dhe represive që kemi marruar, Drejtoria e inspeksionit në bashkëpunim me Policinë e Republikës së Kosovës, lokalet afariste nuk janë përmirësuar nuk i kanë zbatuar urdhëresat e organeve të cekura më lartë.

Në takimin e mbajtur me datën 06.04.2018, të Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, u diskutua kjo çështje dhe raporti i Policisë së Republikës së Kosovës Ref; DDO-04/1-S-ZV-14/18 të datës 03.04.2018 për shqetësimet e dukurive negative në qendrën zeytare Nr-2 në Suharekë, pas diskutimit ky këshill i rekomandoj, Kuvendit të Komunës në Suharekë që të merr vendim për ndryshimin apo ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarive të lokaleve në qendrën zeytar Nr-2, si kafitërit, diskotekat, klubet e natës, lojërat e fatit, bastoret sportive dhe lokaleve tjera që shërbejnë pije alkoolike me qëllim të mbrojtjes dhe krijimit të kushteve për sigurinë e të rinjve nga dukurit negative dhe zhvillimin e procesit mësimor në kushte normale.

Po ashtu edhe nga akteret tjerë kompetent të arsimit janë paraqitur ankesa si nga Drejtoria e Arsimit, Drejtorit e dy shkollave të cekuar më lartë dhe raport nga Drejtoria e inspeksionit, që kërkojnë të merren masa urgjent për lokalet afariste që ushtrojnë veprimtarinë, të cekura në neni 1 të këtij vendimi, me arsyetimin se këto lokale vazhdimisht bëjnë prishjen e siguris publik dhe pengesa në zhvillimin e procesit mësimor.

### Neni 3

**Obligohen;** lokalet afariste të cilat ushtrojnë veprimtarin të cekur në nenin 1, të këtij vendimi që në afat prej 2 (dy) muaj të bëjnë ndryshimin e veprimtarisë, në të kundërtën do të merren masa ligjore nga organet kompetente.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria e inspeksionit, Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe Policia e Republikës së Kosovës.

### Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr-016-20279  
Me datë 26.04.2018



Kryetari i Kuvendit

Bexhet KUÇI